



**VENDIM**

**Nr. 191, datë 22.12.2016**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË  
OST SH.A. PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT TË  
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2017**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 21 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike“ dhe nenit 22 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 22.12.2016, pasi shqyrtoi, relacionin e Drejtorive Teknike,

**Konstatohet se:**

Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2017.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

**Vendos:**

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të OST sh.a. për përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a për vitin 2017.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë shoqërinë OST sh.a për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.